REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-180/3156
Nr. i faq. 2
Data 07/05/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/30
Datë: 30.04.2026

Në bazë të nenit 12,40 dhe 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr.03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 7 dhe 8 të Ligjit Nr.04/L-164 për Financimin e Programeve të veçanta të Banimit, nenit 5,6 dhe 8, të Ligjit Nr.03/L-164, Neni 3,4,5,21,22,25 si dhe dispozitave përkatëse të legjislacionit për banim social dhe mirëqenie sociale në Republikën e Kosovës, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tijë të rregullt të mbajtur më 30.04.2026 nxjerrë:

VENDIM

për inicimin e procedurave për hartimin e planit tre-vjeçar për banim social në Komunën e Junikut (2026 – 2028)

I. Me këtë vendim inicohen procedurat për hartimin e Planit tre-vjeçar për banim social në Komunën e Junikut për periudhën 2026-2028, në përputhje me politikat shtetërore për banim social dhe zhvillim të qëndrueshëm lokal.

II. Planit tre-vjeçar për banim social do të përfshijë:

- Identifikimin e nevojave për banim social në Komunë,
- Kategorizmin e përfituesve sipas legjislacionit në fuqi për banim social,
- Planifikimin e projekteve për ndërtim, renovim dhe subvencionim të banimit,
- Planifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale për qëllime banimi,
- Burimet financiare (buxheti komunal, grantet dhe donacionet),
- Mekanizmat për zbatimin dhe monitorimin e planit.

III. Autorizohet Kryetari i Komunës që brenda afatit prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të themelojë Grupin punues për hartimin e Planit tre-vjeçar për banim social.

IV. Grupi punues është i obligurar që draftin e Planit tre-vjeçar për banim social ta përgatisë dhe ta dorëzojë për shqyrtim në Kuvendin Komunal brenda afatit prej 90 ditësh nga themelimi i tijë.

V. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL,
2. Kryetari i Komunës së Junikut,
3.Shërbimi i Kuvendit të Komunës,
4.Drejtoria e SHMS-së në Komunën e Junikut,
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard I. Iolluni